

38  
08.01.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST  
Tiranë, më 07. 01. 2019

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

**Prof. Dr. Agron CUKA**

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Dhjetor i NJSBC-së pranë UST.**

**RAPORT**

Gjatë muajit Dhjetor 2018 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga: Prof. Dhimitraq Stratobërdha Kryetar, Dr. Mirjeta Cenaj dhe Doc. Anduela Lile Anëtarë, në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nenligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018 ka përpunuar informacionet e mara gjatë këtij viti nga institucionet në vartësi të Ministrisë Arsimit e Sporteve, nga njësitë kryesore UST, administrata e UST si pjesë e dokumentacionit të kësaj njësie në përputhje me ligjin e aktet e tjera nenligjore.

Per vitin 2018 iu kushtua rendesi vlerësimit të cilësisë në programin Master në Menaxhim, të FVFR, dhe NJSBC përfundoi fazën e dytë të vlersimeve si UST, për të patur një tregues real të nivelit të standardeve ku do të arrijë cdo IAL dhe që do të jetë si bazë të dhënash për krahasimin e nivelit të cilësisë në të ardhmen.

Sic edhe kemi raportuar muajin e kaluar, para sezonit të provimeve perfundimtare te vitit akademik 2017-2018 u përgatit një pyetsor për studentët e UST për të tërhequr mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.

On line dhe me pyetsore në auditorë u realizuan gjithësej si UST një numer I konsiderueshëm, gjithësej 232 studentë. nga këto 102 nga FVFR dhe 130 nga FSHL.

Përpunimi i të dhënave u përgatit si draft raport gjatë Nëntorit, dhe u përfundua këtë muaj e që ju dërgua juve në përputhje me plan veprimin tone dhe ashtu si përcaktohet ligji e aktet e tjera nenligjore. Ky raport në përputhje me detyrat dhe detyrimin që ka NJSBC shërbeu si pjesë e raportit tuaj të analizës vjetore. Për 2018 nga të dhënat e mbledhura ka patur nje perceptim dhe pershtypje pozitive e te kenaqshme te studenteve per nivelin e programeve dhe implementimin e tyre nga pedagoget.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03. 2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari I NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha